

Hagë, 18 maj 2022

## **Përmbledhje e Aktgjykimit**

**në**

### **çështjen gjyqësore Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt (KSC-BC-2020-07)**

*Në vazhdim gjeni përmbledhjen e Aktgjykimit të dorëzuar nga Trupi Gjyqësor II, të lexuar nga Kryegjykatësi.*

**TRUPI GJYKUES II** është mbledhur sot për shqiptimin e Aktgjykimit në çështjen gjyqësore Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt. Ky Aktgjykim shqiptohet publikisht, në emër të popullit të Kosovës dhe në prani të të akuzuarve.

Tani unë do të lexoj një përmbledhje të konstatimeve kryesore të Trupit Gjyqësor. Kjo përmbledhje nuk është pjesë e Aktgjykimit dhe nuk është autoritare. Aktgjykimi në formë të shkruar është i vetmi version autoritar i konstatimeve të Trupit Gjyqësor. Palëve do t'u vihen në dispozicion kopje konfidenciale të Aktgjykimit dhe pas kësaj seance publikut do t'i vihet në dispozicion një version i redaktuar publik i tij.

Kjo çështje gjyqësore ka të bëjë me veprimet dhe sjelljen e të akuzuarve **Hysni Gucati** dhe **Nasim Haradinaj**, ndërmjet datave 7 dhe 25 shtator 2020.

Kjo çështje është e rëndësishme, sepse pasqyron vetë arsyen pse u krijuan Dhomat e Specializuara. Kjo çështje ka të bëjë me administrimin e duhur të drejtësisë, integritetin dhe sigurinë e proceseve gjyqësore dhe, çka është më e rëndësishme, sigurinë, mirëqenien dhe çlirimin nga frika të qindra personave, të cilët janë paraqitur për të përmbushur detyrën e tyre qytetare si dëshmitarë. Mbrojtja e tyre nga frikësimi dhe dëmtimi qëndron në themelin e çdo sistemi të drejtësisë penale, qoftë ai vendor apo ndërkombëtar. Pa dëshmitarë, nuk mund të ketë drejtësi për viktimat apo për

shoqërinë në përgjithësi. Veprimet dhe sjellja e të akuzuarve sfiduan pikërisht këtë themel.

## **Ngjarjet në shqyrtim**

Faktet e kësaj çështjeje gjyqësore mund të përmbliidhen si më poshtë.

Në tri ditë – 7 shtator, 16 shtator dhe 22 shtator 2020 – persona të panjohur dorëzuan tri grupe dokumentesh (“tri grupet”) në mjediset e Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (“OVL-UÇK”) në Prishtinë.

Dokumentet kishin lidhje me punën dhe hetimet e Task Forcës Hetimore Speciale (“TFHS”) dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar (“ZPS”). Pas çdo dorëzimi të dokumenteve, të akuzuarit thirrën dhe organizuan konferencë për shtyp në të cilën ata diskutuan dhe u vunë në dispozicion gazetarëve materialin që u ishte dorëzuar (“tri konferencat për shtyp”). Krahas kësaj, të akuzuarit morën pjesë, së bashku, vetëm ose në prani të të tjerëve, edhe në më shumë se njëzet intervista në media, në të cilat ata diskutuan, lexuan ose përshkruan përmbajtjen e tre grupeve të dokumenteve. Gjithashtu, ata ripublikuan artikuj në mediat sociale në lidhje me tre grupet e dokumenteve dhe bënë komente nënçmuese dhe fyese në lidhje me dëshmitarët dhe dëshmitarët e mundshëm, emrat e të cilëve ishin në ato dokumente.

Në përpjekje për të ndaluar shumëfishimin dhe shpërndarjen e dokumenteve, Gjykatësi i Vetëm i Dhomave të Specializuara dhe ZPS-ja, lëshuan urdhra. Përkundër këtyre urdhrave, të akuzuarit vazhduan t’u vinin në dispozicion gazetarëve informacionin që përmbanin tre grupet e dokumenteve.

Gjatë gjykimit, të akuzuarit nuk kundërshtuan faktin se ata kishin marrë pjesë në tri konferencat për shtyp dhe në paraqitje në media në lidhje me to. Ata nuk kundërshtuan as faktin se kishin pasur në zotërim tre grupet e dokumenteve dhe se u kishin vënë në dispozicion mediave shumë nga informacionet që përmbanin ato grupe

dokumentesh. Përkundrazi, ata pretenduan se kishin vepruar të nisur nga shqetësimi për interesin publik dhe se ishin shtytur nga ZPS-ja për të ndërmarrë veprimet e tyre.

### **Akuzat**

Si rezultat, Prokurori i Specializuar ngriti gjashtë akuza kundër të akuzuarve për shkelje të Kodit Penal të Kosovës ("KPK"):

- Pikat 1 dhe 2, pengim i personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, sipas nenit 401 të KPK-së;
- Pika 3, frikësim gjatë procedurës penale, sipas nenit 387 të KPK-së;
- Pika 4, hakmarrje, sipas nenit 388 të KPK-së; dhe
- Pikat 5 dhe 6, shkelje e fshehtësisë së procedurës, sipas nenit 392 të KPK-së.

Sipas Prokurorit të Specializuar të akuzuarit ishin penalisht përgjegjës për vepra penale përmes: kryerjes, vetëm dhe/ose në bashkëkryerje; tentativës për kryerje; marrëveshjes për kryerje; ndihmës; dhe nxitjes.

Dispozitat ligjore të zbatueshme për këto vepra penale dhe format e përgjegjësisë penale paraqiten hollësisht në Aktgjykim.

### **Konstatimet e Trupit Gjykses në lidhje me tre grupet dhe paketat përkatëse të dokumenteve**

Trupi Gjykses është bindur se ZPS-ja, në tri raste, sekuestroi nga OVL-UÇK-ja atë çka kishte mbetur nga tre grupet e dokumenteve të cilat korrespondojnë me ato që ZPS-ja i përshkruan si Paketat 1, 2 dhe 3. ZPS-së iu dorëzua nga një organ i medias edhe një grup i katërt dokumentesh, që ishte marrë nga një gazetar gjatë konferencës së parë për shtyp. Ky grup dokumentesh korrespondon me Paketën 4.

Paketat përmbanin një sërë informacionesh të ndjeshme, ndër të cilat: kërkesa për ndihmë që TFHS-ja u kishte drejtuar autoriteteve kompetente serbe ("kërkesat e TFHS-së"), të cilat përmbanin emrat dhe të dhënat personale të qindra dëshmitarëve;

përgjigje të Prokurorisë Serbe të Krimeve të Luftës ndaj kërkesave të TFHS-së (“përgjigjet e PSKL-së”); dhe një produkt të materialit të brendshëm të punës së ZPS-së, ku analizoheshin provat dhe aspektet ligjore të ndërlidhura me to në lidhje me pesë persona të dyshuar nga ZPS-ja, i cili gjithashtu përmbante emrat e 150 dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm.

Trupi Gjykses është bindur se materiali në fjalë ishte autentik dhe u përkiste dokumenteve të hetimeve të TFHS-së ose ZPS-së. Gjithashtu, Trupi Gjykses është bindur se materiali ishte trajtuar si konfidencial nga TFHS-ja dhe ZPS-ja.

### **Konstatimet e Trupit Gjykses në lidhje me akuzat**

Tani Trupi Gjykses do të bëjë një përmbledhje të konstatimeve të veta lidhur me akuzat. Fillimisht, Trupi Gjykses do të trajtojë nëse të akuzuarit janë fajtorë për shkeljen e fshehtësisë së procedurës në Pikat 5 dhe 6, më tej akuzat për frikësim dhe hakmarrje në Pikat 3 dhe 4 dhe, në fund, akuzat për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare në Pikat 1 dhe 2.

### **Pikat 5 dhe 6**

Tani do të trajtoj **Pikën 5**, e cila ka të bëjë me veprën penale të përcaktuar në nenin 392(1) të KPK-së. Është fjala për veprën penale të zbulimit të paautorizuar të çfarëdo “informatash të nxjerra në një procedurë zyrtare që sipas ligjit nuk mund të zbulohen apo që janë shpallur si fshehtësi me vendim të gjykatës apo të autoritetit kompetent”.

Trupi Gjykses është bindur se, në kuptim të nenit 391(1) të KPK-së, TFHS-ja/ZPS-ja janë autoritete kompetente për t’i shpallur të dhënat e tyre të fshehta. Trupi Gjykses gjithashtu është bindur se kërkesat e TFHS-së dhe përgjigjet e PSKL-së në Paketat 1, 2 dhe 4 dhe dokumentet e Paketës 3, përmbushin kriteret si informacion që është shpallur i fshehtë nga një autoritet kompetent.

I njëjti material, në bazë të nenit 62 të Ligjit, përmbush kriteret si informacion që sipas ligjit nuk duhet të zbulohet.

Unë do t'u referohem këtyre dokumenteve si "informacioni i mbrojtur".

Trupi Gjykses është bindur se të akuzuarit zbuluan informacionin e mbrojtur në kuptim të nenit 392(1) të KPK-së: duke ekspozuar dokumentet dhe duke lejuar të pranishmit në tri konferencat për shtyp t'i këqyrnin ato; duke ua treguar dokumentet gazetarëve; duke ftuar ose lejuar ata që kishin kamera të filmonin ose të fotografonin dokumentet; duke ftuar ose lejuar të pranishmit të merrnin dokumente me vete; dhe duke paraqitur, përshkruar ose duke iu referuar përmbajtjes së dokumenteve gjatë tri konferencave për shtyp dhe paraqitjeve të tjera në media. Trupi Gjykses gjithashtu konstaton se në kontekstin e kësaj vepre penale, gazetarët janë pjesëtarë të publikut.

Trupi Gjykses është bindur se të akuzuarit vepruan me synim të drejtpërdrejtë për zbulimin e informacionit të mbrojtur. Kjo duket veçanërisht nga: veprimet e tyre; zotimet e tyre për të vijuar me publikimin e çdo dokumenti të marrë, duke deklaruar se ishte detyra e tyre ta bënin këtë; inkurajimi i tyre i përsëritur për gazetarët që të publikonin dokumentet; dhe deklaratat e tyre se mirëprisnin dorëzime të tjera të dokumenteve të tilla.

Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se ZPS-ja ka vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm veprën penale të Pikës 5 në lidhje me të dy të akuzuarit.

**Pika 6** ka të bëjë me formën bazë dhe të rëndë të veprës penale. Forma bazë ka të bëjë me veprën penale të zbulimit "të informacionit për identitetin apo të të dhënave personale të personit të mbrojtur në procedurë penale apo në një program të veçantë të mbrojtjes" sipas nenit 392(2) të KPK-së. Forma e rëndë sipas nenit 392(3) të KPK-së zbatohet në rastet kur zbulimi i identitetit të personave të mbrojtur shkakton "pasoja të rënda" ose kur procedura penale pamundësohet ose pengohet shumë.

Trupi Gjykses është bindur se dëshmitarët dhe dëshmitarët e mundshëm, emrat dhe të dhënat personale të të cilëve përmendeshin në informacionin e mbrojtur,

përmbushin kriteret si persona “të mbrojtur në procedurë penale”, në kuptim të nenit 392(2) të KPK-së. Trupi Gjykses thekson se TFHS-ja/ZPS-ja, në kuadër të hetimeve të tyre, nuk i bënë publike emrat e këtyre dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm.

Trupi Gjykses konstaton se të akuzuarit zbuluan identitetet dhe/ose të dhënat personale të dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm të marrë në mbrojtje nga TFHS-ja/ZPS-ja, në të njëjtën mënyrë siç zbuluan informacionin e mbrojtur. Gjithashtu, të akuzuarit përmendën se në tre grupet me dokumente ishin emra, vendbanime të mëparshme dhe aktuale, numra telefonash, përkatësia etnike, vendet ku ishin zhvilluar intervistat dhe përmbajtja e deklaratave të dëshmitarëve. Ata gjithashtu ftuan gazetarët që të njiheshin me këtë informacion. Gjithashtu, z. Haradinaj përmendi emrat e së paku pesë dëshmitarëve ose dëshmitarëve të mundshëm.

Trupi Gjykses gjithashtu është bindur se të akuzuarit vepruan me synim të drejtpërdrejtë për zbulimin e emrave dhe të dhënave personale të dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm.

Veprimet e të akuzuarve shkaktuan “pasoja të rënda” në kuptim të nenit 392(3) të KPK-së për dy dëshmitarë të cilët u zhvendosën, për dëshmitarë të cilët u bënë objekt i planifikimit urgjent të menaxhimit të rrezikut dhe për së paku një person i cili u përmend publikisht me emër si dëshmitar. Të dy të akuzuarit ishin të vetëdijshëm se si rezultat i veprimeve të tyre mund të shkaktoheshin pasoja të tilla dhe ata u pajtuan me shkaktimin e tyre.

Sidoqoftë, Trupi Gjykses nuk është bindur se veprimet e të akuzuarve pamundësuan apo penguan shumë hetimet e ZPS-së.

Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se ZPS-ja ka vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm formën bazë të veprës penale në Pikën 6 dhe formën e rëndë vetëm sa u përket “pasojeve të rënda” në lidhje me të dy të akuzuarit.

## Pikat 3 dhe 4

**Pika 3** ka të bëjë me veprën penale të frikësimit. Sipas nenit 387 të KPK-së, “kushdo që përdor forcën apo kanosjen serioze apo ndonjë mënyrë tjetër të detyrimit, premtion dhuratë apo ndonjë përfitim tjetër për të nxitur personin tjetër të përmbahet nga dhënia e deklaratës ose për të dhënë deklaratë të rreme, ose për të mos dhënë informacione të vërteta policisë, prokurorit apo gjyqtarit, kur informacione të tilla ndërlidhen me pengimin e procedurës penale”, është fajtor për këtë vepër penale.

Trupi Gjykues ka konstatuar se të akuzuarit zbuluan identitetet dhe/ose të dhënat personale të qindra dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm të përmendur në informacionin e mbrojtur. Gjithashtu, në paraqitjet e tyre publike, të akuzuarit tërhoqën vëmendjen për numrin e madh të dëshmitarëve që ata kishin identifikuar në dokumente dhe theksuan publikisht dhe në mënyrë të përsëritur praninë e emrave të tyre në to.

Përafërsisht 70-80% e materialeve të tre grupeve të dokumenteve u shpërndanë pa u përzgjedhur dhe pa asnjë masë mbrojtëse paraprake të mirëfilltë. Qëllimi ishte të tërhoqej vëmendja e publikut të gjerë. Të akuzuarit nuk i kushtuan rëndësi faktit se ku dhe në duart e kujt do të përfundonte informacioni që ata zbuluan.

Për më tepër, të akuzuarit deklaruan shprehimisht se tashmë dihej nga publiku, përfshirë edhe nga dëshmitarë, se të tjerë e dinin se kush ishin ata. Të akuzuarit bënë deklaratë të përsëritura se kjo gjykatë nuk ishte në gjendje të garantonte privatësinë dhe sigurinë e dëshmitarëve të saj, duke theksuar kështu më tej cenueshmërinë e tyre. Të akuzuarit përdorën platformën e përbashkët të OVL-UÇK-së dhe funksionet e tyre zyrtare brenda kësaj organizate për të kryer veprimet e tyre.

Gjithashtu, të akuzuarit vunë publikisht në dyshim vërtetësinë e informacionit të dhënë nga dëshmitarët, duke i quajtur ata “gënjeshtarë” dhe duke pretenduar pa ndonjë arsye të besueshme se ata kishin dhënë dëshmi për të nxjerrë përfitime, apo sepse ishin detyruar. Të akuzuarit gjithashtu iu referuan dëshmitarëve dhe

dëshmitarëve të mundshëm me një gjuhë nënçmuese dhe kërcënuese, duke i quajtur ata “tradhtarë”, “spiunë”, “bashkëpunëtorë” dhe “shqipfolsa”, duke i bërë kështu jehonë një retorike të njohur, e cila synonte të ngjallte armiqësi ndaj atyre që kishin zgjedhur të bashkëpunonin me ZPS-në.

Mesazhi i të akuzuarve për këta dëshmitarë ishte: tani që të gjithë e dinë se kush je, askush nuk mund të të mbrojë, sepse je “tradhtar”, “spiun”, “bashkëpunëtor”, “shqipfolës”, që nuk “ia do të mirën Kosovës dhe UÇK-së”.

Këto veprime dhe deklarata u bënë në një atmosferë të frikësimit të dëshmitarëve. Trupi Gjykses është i vetëdijshëm se format tinëzare të frikësimit të dëshmitarëve iu kanë hequr vazhdimisht viktimave mundësinë për të thënë të vërtetën në lidhje me krimet e kryera ndaj tyre, dhe kanë penguar ndjeshëm përpjekjet për pajtim në shoqëritë e dala nga konfliktet. Autoritetet në Kosovë dhe në Tribunalin e Hagës, janë përpjekur për vite me radhë të luftojnë atmosferën e frikësimit të dëshmitarëve, e cila ka pasur një ndikim të madh në hetimet dhe ndjekjen penale të krimeve që kanë ndodhur në Kosovë. Të akuzuarit e dinin mirë këtë.

Trupi Gjykses konstaton se veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve shkaktuan kërcënim të rëndë, i cili do të kishte krijuar frikë dhe shqetësime të rënda për shumë dëshmitarë apo dëshmitarë të mundshëm.

Gjithashtu, Trupi Gjykses është bindur se të akuzuarit e përdorën këtë kërcënim të rëndë me synimin e drejtpërdrejtë për t’i frikësuar dëshmitarët dhe dëshmitarët e mundshëm dhe, për pasojë, për t’i bërë të ngurronin që të jepnin informacion në hetimet lidhur me ish-anëtarë të UÇK-së. Sjellja e të akuzuarve ishte mjete që shërbente për një qëllim: për të penguar hetimet dhe ndjekjet penale të efektshme të ish-anëtarëve të UÇK-së nga ZPS-ja. Thënë thjesht: pa dëshmitarë, nuk do të kishte gjykime; dhe pa gjykime, nuk do të kishte dënime të atyre që nga njëri prej të akuzuarve u cilësuan si “djemtë e Kosovës”.



Trupi Gjykses konstaton se ZPS-ja ka vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm veprën penale të Pikës 3 në lidhje me të dy të akuzuarit.

**Pika 4** ka të bëjë me veprën penale të hakmarrjes. “Kushdo që ndërmer ndonjë veprim të dëmshëm për cilindo person, përfshirë ndërhyrjen në punësimin e ligjshëm apo sigurimin e mjeteve të jetesës së ndonjë personi me qëllim të hakmarrjes për shkak të dhënies së informatave të vërteta policisë, hetuesit të autorizuar, prokurorit apo gjyqtarit, lidhur me kryerjen ose kryerjen e mundshme të veprës penale”, është fajtor për veprën penale sipas nenit 388(1) të KPK-së.

Trupi Gjykses ka konstatuar në Pikën 3 se veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve përbënin kërcënim të rëndë. I njëjti konstatim vlen edhe për Pikën 4. Veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve, në kuptim të nenit 388(1) të KPK-së, përbënin “veprime të dëmshme për cilindo person”.

Trupi Gjykses thekson se pretendimet e të akuzuarve se dëshmitë e dëshmitarëve ishin të pavërteta, nuk vërtetojnë në vetvete se të akuzuarit e besonin këtë gjë. Sidoqoftë, Trupi Gjykses thekson se ZPS-ja nuk paraqiti ndonjë provë për t'i kundërshtuar këto deklarata. Kjo nuk vë në asnjë mënyrë në pikëpyetje besueshmërinë e dëshmitarëve ose dëshmitarëve të mundshëm, emrat e të cilëve përmendeshin në informacionin e mbrojtur. Megjithatë, sipas nenit 388(1) të KPK-së, është ZPS-ja ajo që ka detyrimin të vërtetojë se të akuzuarit ishin të vetëdijshëm se informacionet e dëshmitarëve kishin të paktën deri në një farë mase, vërtetësi. ZPS-ja nuk arriti të vërtetonte se të akuzuarit ishin të vetëdijshëm për këtë.

Për këto arsye, Trupi Gjykses konstaton se ZPS-ja nuk ka arritur të vërtetojë se të akuzuarit vepruan me synimin e nevojshëm ndaj cilitdo prej dëshmitarëve, të cilit ata i zbuluan identitetin dhe/ose të dhënat personale. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se ZPS-ja nuk ka arritur të vërtetojë përtej dyshimit të arsyeshëm veprën penale të Pikës 4 në lidhje me të dy të akuzuarit.

## **Pikat 1 dhe 2**

**Pika 1** ka të bëjë me veprën penale të pengimit të personave zyrtarë me anë të forcës ose kërcënimit të rëndë: “Kushdo që me forcë apo kanosje serioze, pengon ose tenton të pengojë personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare ose duke përdorur mjetet e njëjta e detyron atë të kryejë detyrën zyrtare” është fajtor për veprën penale sipas nenit 401(1) të KPK-së. Kjo është forma bazë e kësaj vepre penale. Forma e rëndë e kësaj vepre zbatohet në rastet kur forma bazë kryhet kundër kategorive të veçanta të personave, përfshirë kundër “gjqtarit, prokurorit [ose] zyrtarit të gjykatës”.

Trupi Gjykues konstatoi në lidhje me Pikën 3 se veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve përbënin kërcënim të rëndë. I njëjti konstatim vlen edhe për Pikën 1. Për këto arsye, Trupi Gjykues konstaton se, në kuptim të nenit 401(1) të KPK-së, veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve përbëjnë “kanosje serioze”.

Trupi Gjykues rithekson se kryerja e detyrave zyrtare në kuadër të DHS-së dhe ZPS-së varet në një masë të madhe nga gatishmëria dhe aftësia e dëshmitarëve për t’u paraqitur dhe për të dhënë lirisht dëshmitë e tyre.

Trupi Gjykues ka konstatuar se veprimet e të akuzuarve shkaktuan pasoja të rënda për një numër dëshmitarësh ose dëshmitarësh të mundshëm, por Trupit Gjykues nuk i është paraqitur asnjë provë se sjellja e të akuzuarve faktikisht bëri që ndonjë nga këta persona apo ndonjë dëshmitar tjetër të mos jepte më dëshmi për DHS-në/ZPS-në. ZPS-ja gjithashtu nuk ka demonstruar pengesë konkrete dhe aktuale që i është shkaktuar hetimeve të saj, për të cilën përgjegjësia do të mund t’i atribuohet veprimeve të të akuzuarve. Gjithashtu, nuk ka ndonjë të dhënë se si rezultat i devijimit të kohës dhe kapaciteteve, ZPS-ja u pengua ose u vonua në kryerjen e funksioneve të saj të zakonshme.

Për këto arsye, Trupi Gjykues konstaton se ZPS-ja nuk ka arritur të vërtetojë se veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve penguan zyrtarët e DHS-së/ZPS-së në kryerjen e detyrave të tyre zyrtare.

Sidoqoftë, Trupi Gjykses rikujton se vepra penale sipas nenit 401(1) të KPK-së mund të kryhet edhe nëse pengimi tentohet por nuk çohet deri në fund. Pasi konstatoi se veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve përbënin kërcënim të rëndë, Trupi Gjykses konstaton se të akuzuarit tentuan të pengonin zyrtarët e DHS-së/ZPS-së në kryerjen e detyrave të tyre zyrtare.

Trupi Gjykses është bindur se të akuzuarit këtë e bënë me synim të drejtpërdrejtë. Kjo shihet qartë nga pretendimet e të akuzuarve se ishte detyra e tyre të bënin të njohur informacionin e mbrojtur, për të nxjerrë në pah se sa - sipas fjalëve të tyre - "skandaloze", "të turpshme" dhe "të papranueshme" - ishin DHS-ja/ZPS-ja për faktin se "bashkëpunonin" me autoritetet serbe dhe me dëshmitarë jo të besueshëm, dhe për faktin se nuk i mbronin këta dëshmitarë. Gjatë kryerjes së asaj që të akuzuarit e përshkruan si "detyrë" të tyre për të zbuluar informacionin e mbrojtur, të akuzuarit gjithashtu deklaruan se dështimi i DHS-së/ZPS-së ishte i pashmangshëm. Të dy të akuzuarit i bënë të qarta synimet e tyre për të mos iu bindur urdhrave të DHS-së/ZPS-së. Gjithashtu, të dy të akuzuarit deklaruan shprehimisht se ata donin të ndalnin ose të dëmtonin proceset e DHS-së/ZPS-së, në mënyrë që ajo të cilën ata e përshkruan si një gjykatë "pa vlerë" dhe "e njëanshme" të mos ndiqte penalisht "djemtë e Kosovës".

Trupi Gjykses konstaton se veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve tregojnë qartë dëshirën për të penguar marrjen e dëshmive të dëshmitarëve nga hetuesit dhe prokurorët e ZPS-së, gjë që përmbush kriteret e formës së rëndë të veprës penale.

Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se ZPS-ja ka vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm formën bazë dhe të rëndë të veprës penale të Pikës 1 në lidhje me të dy të akuzuarit.

**Pika 2** ka të bëjë me veprën penale të pengimit të personave zyrtarë me anë të veprimeve të përbashkëta si grup. "Kushdo që merr pjesë në një grup personash që me veprim të përbashkët pengon ose tenton të pengojë personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, ose duke përdorur mjetet e njëjta e detyron atë të kryejë detyrën zyrtare" është fajtor për veprën penale sipas nenit 401(2) të KPK-së. Pika 2 përfshin

gjithashtu të njëjtën formë të rëndë si në Pikën 1 dhe një formë tjetër të rëndë, e cila zbatohet në rastet kur veprën penale e kryen “udhëheqësi apo organizatori i grupit”.

Trupi Gjykses është bindur se të akuzuarit nuk vepruan të vetëm në zbulimin e informacionit të mbrojtur.

Provat vërtetojnë se z. Gucati, z. Haradinaj dhe z. Faton Klinaku vepruan si grup: përmes ndarjes midis tyre të detyrës së organizimit të tri konferencave për shtyp; përmes paraqitjes së informacionit që përmbanin tre grupet e dokumenteve; përmes kontakteve me ZPS-në; dhe përmes shprehjes së qëndrimeve të përbashkëta gjatë paraqitjeve në media lidhur me zbulimin e informacionit të mbrojtur dhe pengimin e DHS-së/ZPS-së.

Siç përcaktohet në Pikën 1, të akuzuarit vepruan me synim të drejtpërdrejtë për të penguar zyrtarët e DHS-së/ZPS-së në kryerjen e funksioneve të tyre. Trupi Gjykses konsideron se ky konstatim vlen edhe për Pikën 2 dhe konstaton se të akuzuarit vepruan në grup me synimin e drejtpërdrejtë për të penguar me anë të veprimeve të përbashkëta, zyrtarët e DHS-së/ZPS-së, në kryerjen e funksioneve të tyre.

Trupi Gjykses është bindur se të akuzuarit dhe z. Klinaku, në përpjekjet e tyre për të zbuluar informacionin e mbrojtur dhe për të penguar zyrtarët e DHS-së/ZPS-së në kryerjen e funksioneve të tyre zyrtare, vepruan nën autoritetin e z. Gucati si kryetar i OVL-UÇK-së. Për këto arsye, Trupi Gjykses është bindur se z. Gucati veproi si udhëheqës i grupit. Z. Haradinaj veproi nën autoritetin e z. Gucati dhe luajti rol të qenësishëm si anëtar i grupit. Trupi Gjykses nuk është bindur se ai veproi si udhëheqës apo organizator i grupit.

Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se ZPS-ja ka vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm veprën penale sipas nenit 401(2) dhe (5) në lidhje me të dy të akuzuarit. Trupi Gjykses gjithashtu konstaton se ZPS-ja ka vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm formën e rëndë të veprës penale sipas nenit 401(3) të KPK-së në lidhje me z. Gucati.

## **Format e përgjegjësive penale**

Lidhur me llojin e pjesëmarrjes së të akuzuarve në këto vepra penale, Trupi Gjykes konstaton se të akuzuarit morën pjesë bashkërisht dhe dhanë kontribut thelbësor si bashkëkryes në kryerjen e veprave penale të Pikave 1, 3, 5 dhe 6. Trupi Gjykes gjithashtu konstaton se z. Gucati dhe z. Haradinaj kryen individualisht veprën penale të Pikës 2.

Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykes konstaton se të akuzuarit janë penalisht përgjegjës si bashkëkryes për veprat penale të Pikave 1, 3, 5 dhe 6 dhe si kryes individuale për veprën penale të Pikës 2.

## **Argumentet mbrojtëse**

Tani do të trajtoj argumentet e paraqitura nga të akuzuarit për të arsyetuar veprimet e tyre. Për sa i përket interesit publik, Trupi Gjykes konstaton se nuk ka arsye të besueshme për të nxjerrë përfundimin se informacioni i mbrojtur, i zbuluar nga të akuzuarit, përmbante të dhëna për parregullsi të kryera nga TFHS-ja/ZPS-ja, ose se veprimet e të akuzuarve ishin të arsyetuar pasi ata udhëhiqeshin nga interesi i pretenduar publik.

Trupi Gjykes më tej konstaton se asnjë prej të akuzuarve nuk mund të konsiderohet si sinjalizues dhe se veprimet e tyre dalin jashtë kuadrit të mbrojtjes që u garantohet personave të tillë sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe legjislacionit të Kosovës, ndër të tjera edhe Kushtetutës së Kosovës.

Në lidhje me pretendimin e shtytjes për kryerje të veprës penale, Trupi Gjykes konstaton se Mbrojtjes iu ofrua në mënyrë të plotë dhe të drejtë mundësia për të argumentuar këtë pretendim bazuar në standardet e përcaktuara nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, të cilave Trupi Gjykes iu përmbahet plotësisht. Trupi Gjykes më tej konstaton se as deklaratat e të akuzuarve në atë kohë, as dëshmitë e tyre në gjykim nuk ofrojnë arsye objektive për të besuar se të akuzuarit janë shtytur. Trupi Gjykes ka analizuar me kujdes argumentet e parashtruara nga

Mbrojtja e Gucatit si prova rrethanore të shtytjes dhe konstaton se ato nuk ofrojnë një bazë të arsyeshme për të arritur në përfundimin se ka pasur shtytje. Trupi Gjykses konstaton se pretendimi për shtytje është tërësisht i pagjasë dhe i pabazë.

Sa i përket lajthimit ligjor, Trupi Gjykses është i bindur se gjatë periudhës që përfshin Aktakuza, të akuzuarit e dinin se sjellja e tyre ishte ligjërish e ndaluar dhe se, gjithsesi, nuk kishin arsye të justifikueshme që të mos dinin se ishte ligjërish e ndaluar.

Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se përgjegjësia penale e të akuzuarve nuk mund të përjashtohet mbi bazën e elementit të interesit publik, pretendimit për shtytje, apo argumentit mbrojtës për lajthim ligjor.

Trupi Gjykses gjithashtu konstaton se përgjegjësia penale e të akuzuarve nuk mund të përjashtohet mbi bazën e argumenteve mbrojtëse të nevojës ekstreme, lajthimit faktik dhe veprimeve të një rëndësie të vogël.

## **Dënimi**

Tani do të trajtoj dënimin. Të akuzuarit janë përgjegjës për vepra të rënda penale, të cilat rrezikojnë administrimin e duhur të drejtësisë.

Me gjithë lëshimin e urdhrave nga Gjykatësi i Vetëm dhe ZPS-ja, të akuzuarit vazhduan të shpërndanin në shkallë të gjerë informacionin e mbrojtur që përfshinte emrat e qindra dëshmitarëve të mbrojtur, përmes konferencave të organizuara për shtyp dhe paraqitjeve të tjera në media. Ata e bënë këtë në mënyrë të përsëritur e me entuziazëm dhe u zotuan se do ta bënin sërish. Të akuzuarit i trajtuan me përbuzje dhe fyerje ata që zgjodhën të bashkëpunojnë me këtë gjykatë në kërkim të së vërtetës dhe u shprehën në një mënyrë që mund të kishte vetëm synimin që t'i bindte ata që të mos i jepnin asnjë informacion ZPS-së, as të dëshmonin në ndonjë gjykim të ardhshëm. Sjellja e të akuzuarve ndikoi mbi një numër të madh njerëzish dhe shkaktoi frikë dhe shqetësim te disa prej tyre.

Të akuzuarit nuk treguan shqetësim për pasojat apo pasojat e mundshme të veprimeve të tyre. Ata vepruan në mënyrë flagrante, haptazi, pa bërë dallime dhe duke shpërfilluar sundimin e ligjit apo autoritetin e kësaj gjykate.

Ky aktgjykim i përshkruan qartë këto veprime ashtu siç janë: kriminale dhe jopatriotike; kërcënim për drejtësinë dhe jo të udhëhequra nga interesi publik.

Trupi Gjykses konstaton se nuk ka faktorë të tjerë rëndues sa i përket kontributit të të akuzuarve në kryerjen e këtyre veprave të rënda penale.

Trupi Gjykses konsideron si faktorë lehtësues situatën familjare dhe/ose shëndetësore të të dy të akuzuarve, si dhe në lidhje me z. Gucati, punën e tij në komunitet.

Kjo ishte përmbledhja e konstatimeve të Trupit Gjykses.

Tani do të lexoj vendimin.

## **Vendim**

Z. Hysni Gucati, ju lutem ngrihuni në këmbë.

Në emër të popullit të Kosovës, për arsyet e shtjelluara në Aktgjykim dhe të përmbledhura më lart, dhe duke marrë parasysh të gjitha provat dhe argumentet e palëve, Trupi Gjykses, në bazë të neneve 43 dhe 44 të Ligjit dhe rregullave 158, 159, 163 dhe 165 të Rregullores, ju shpall ju, z. Gucati, **FAJTOR** për:

- a) Pika 1, pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, nëpërmjet kërcënimit të rëndë, sipas neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit dhe neneve 17, 31 dhe 401(1) dhe (5) të KPK-së;
- b) Pika 2, pengim të personave zyrtare në kryerjen e detyrave zyrtare nëpërmjet pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi, sipas neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit dhe neneve 17 dhe 401(2), (3) dhe (5) të KPK-së;
- c) Pika 3, frikësim gjatë procedurës penale, sipas neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit dhe neneve 17, 31 dhe 387 të KPK-së;

- d) Pika 5, shkelje të fshehtësisë së procedurës, nëpërmjet zbulimit të paautorizuar të informacionit të fshehtë të nxjerrë në procedura zyrtare, sipas neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit dhe neneve 17, 31 dhe 392(1) të KPK-së; dhe
- e) Pika 6, shkelje të fshehtësisë së procedurës, nëpërmjet zbulimit të paautorizuar të identitetit dhe të dhënave personale të dëshmitarëve të mbrojtur, sipas neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit dhe neneve 17, 31, 392(2) dhe (3) të KPK-së.

Trupi Gjykses ju shpall **TË PAFAJSHËM** për Pikën 4, Hakmarrje.

Trupi Gjykses ju dënon me një dënim të njësuar prej **katër vjetësh e gjysmë** burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim, dhe me një gjobë prej njëqind eurosh (100 Euro), të cilën duhet ta paguani deri më 18 korrik 2022.

Z. Gucati, mund të uleni.

Z. Nasim Haradinaj, ju lutem ngrihuni në këmbë.

Në emër të popullit të Kosovës, për arsyet e shtjelluara në Aktgjykim dhe të përmbledhura më lart, dhe duke marrë parasysh të gjitha provat dhe argumentet e palëve, Trupi Gjykses, në bazë të neneve 43 dhe 44 të Ligjit dhe rregullave 158, 159, 163 dhe 165 të Rregullores, ju shpall ju, z. Haradinaj, **FAJTOR** për

- a) Pika 1, pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, nëpërmjet kërcënimit të rëndë, sipas neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit dhe neneve 17, 31 dhe 401(1) dhe (5) të KPK-së;
- b) Pika 2, pengim të personave zyrtare në kryerjen e detyrave zyrtare nëpërmjet pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi, sipas neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit dhe neneve 17 dhe 401(2) dhe (5) të KPK-së;



- c) Pika 3, frikësim gjatë procedurës panele, sipas neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit dhe neneve 17, 31 dhe 387 të KPK-së;
- d) Pika 5, shkelje të fshehtësisë së procedurës, nëpërmjet zbulimit të paautorizuar të informacionit të fshehtë të nxjerrë në procedura zyrtare, sipas neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit dhe neneve 17, 31 dhe 392(1) të KPK-së; dhe
- e) Pika 6, shkelje të fshehtësisë së procedurës, nëpërmjet zbulimit të paautorizuar të identitetit dhe të dhënave personale të dëshmitarëve të mbrojtur, sipas neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit dhe neneve 17, 31, 392(2) dhe (3) të KPK-së.

Trupi Gjykes ju shpall **TË PAFAJSHËM** për Pikën 4, Hakmarrje.

Trupi Gjykes ju dënon me një dënim të njësuar prej **katër vjetësh e gjysmë** burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim, dhe me një gjobë prej njëqind eurosh (100 Euro), të cilën duhet ta paguani deri më 18 korrik 2022.

Z. Haradinaj, mund të uleni

Tani, Zyra Administrative do të shpërndajë Aktgjykimin në formë elektronike dhe do t'u japë të akuzuarve kopje të legalizuara të versionit të tij në gjuhën angleze. Versioni në gjuhën shqipe do t'u jepet të akuzuarve pasi të jetë gati.

Seanca mbyllet.